

## **RELACION PËR**

### **PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Propozimi i projektligjit është mbështetur ne nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Projektligji parashikon vendosjen e një takse prej 100 lek/kg për qumështin pluhur për tregti. Ky propozim konkretisht synon që të incentivojë prodhimin dhe tregtimin në vend të qumështit, me synim mbështetjen e fermerëve vendas. Kjo, duke marrë në konsideratë dhe faktin se, sektori i qumështit konsiderohet si sektor me përparësi nisur nga potenciali për zëvendësimin e importit.

Në këtë kuadër propozohet dhe vendosja e taksës për hurrë qumështi në vlerën 150 lekë për kg dhe ajo e taksës për krem qumështi në vlerën 150 lekë për litër. Gjithashtu, përcaktohet dhe taksa për pijen e homogjenizuar në vlerën 16 lekë për litër.

Për më tepër, me qëllim shmangien e abuzimeve dhe përfitimeve të padrejta nga mjete lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, që furnizohen me karburant në zonat e lira doganore/magazinat doganore, propozohet vendosja e një takse prej 65 lekë/litër mbi karburantin që përdoret për furnizimin e këtyre mjeteve lundruese në këto zona.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ky projektligj synon të mbështesë blegtorinë, që është një sektor agrorshqimor shumë i rëndësishëm në Shqipëri, pasi rreth 1/2 e fermerëve janë të angazhuar në blegtori, duke përfshirë sektorin e bulmetit.

Konkretisht, sektori i qumështit është një nga sektorët kryesorë agroushqimorë dhe prodhimi i qumështit ka pësuar rënie gjatë viteve të fundit. Konkretisht prodhimi i qumështit në vitin 2020 ka shënuar një rënie me 5,39 %, në krahasim me vitin 2019. Gjithashtu, rënie ka pësuar dhe sasia e qumështit të grumbulluar. Kështu, në vitin 2020, sasia gjithsej e qumështit të grumbulluar rezulton rreth 119 mijë ton nga rreth 140 ton që ishte në vitin 2019, duke pësuar një rënie prej rreth 14,80 %, krahasuar me vitin 2019.

Ndërkohë, vihet re një rritje në produktet që importohen për prodhimin e produkteve të bulmetit, ndër të cilët mjaft i rëndësishëm është qumështi pluhur. Kështu, sasia e importuar e këtij produkti për vitin 2020 ka qenë në masën mbi 1.400 ton/vit, sasi kjo rreth 2.5 herë më e lartë krahasuar me atë të vitit 2016 që ka qenë rreth 560 ton/vit. Qumështi pluhur përdoret në agroindustri (shpesh përzihet me qumësht të freskët) për të prodhuar produkte bulmeti, pjesërisht për të përballuar kostot e qumështit të freskët dhe pjesërisht për të mbuluar mungesat/hendekun ndërmjet sezonalitetit të kërkesës nga njëra anë dhe të ofertës së qumështit të freskët (të papërpunuar) në anën tjetër.

Në këtë kuadër propozohet dhe vendosja e taksës për hirrë qumështi në vlerën 150 lekë për kg dhe ajo e taksës për krem qumështi në vlerën 150 lekë për litër. Referuar një importi mesatar prej rreth 150 mijë kg hirrë qumështi në vit, (sipas të dhënave të viteve 2019, 2020 dhe 2021), me vendosjen e taksës 150 lek/kg parashikohet një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me rreth + 22.5 milion lekë në vit. Gjithashtu, nga vendosja e taksës për pijen e homogjenizuar 16 lek/litër parashikohet një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me rreth + 7.8 milion lekë në vit.

Ky projektligj ka si qëllim dhe shmangien e abuzimeve dhe përfitimeve të padrejta nga mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, të cilat furnizohen me karburant në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore. Për këtë qëllim propozohet vendosja e një takse prej 65 lekë/litër mbi karburantin (e cila përfshin, akcizën (37 lekë), taksë qarkullimi (27 lekë) dhe taksë karboni (1.5 lekë) që përdoret për furnizimin e tyre në këto zona. Pasi depozitohet në zonë të lirë, karburanti shkon në këto destinacione:

1. Import në Republikën e Shqipërisë për të cilin paguhet taksa doganore, akciza, taksa e qarkullimit, taksa e karbonit, TVSH; dhe
2. Rieksport, ku një pjesë të konsiderueshme e zë furnizimi i mjeteve lundruese për qëllime argëtimi, për të cilin niveli i taksimit është zero, rreth 18 mijë ton në vit.

Këto mjete lundruese, si p.sh. jahtet furnizohen pa taksa, pasi konsiderohen si furnizime që ndodhin jashtë territorit të RSH., për pasojë dhe çmimi me të cilin,

jahtet e blejnë karburantin është shumë i ulët. Aplikimi i taksës prej 65 lekë/litër sjell rritje të ardhurash në buxhet, duke qenë në të njëjtën kohë një taksë më e ulët se ajo e karburantit që importohet në kushte normale, për të cilin taksat në total janë rreth 90 lekë/litër taksa (TD+A+TQ+TK+TVSH). Ky aplikim është në analogji dhe me direktivën e Këshillit Evropian 2003/96/EC e 27 tetorit 2003 “Ristrukturimi i kuadrit të Komunitetit për taksimin e produkteve të energjisë dhe të energjisë elektrike”. Kjo, pasi sipas kësaj direktive janë të përjashtuara nga akciza lëndët djegëse për furnizimin e mjeteve lundruese përveç ‘mjeteve lundruese private të argëtimit’ edhe kur ky furnizim kryhet brenda ujërave të Komunitetit Evropian.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PERMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet nga 5 nene:

Neni 1, parashikon që në nenin 3, “Llojet e taksave kombëtare” shtohen 12 deri 16, me këtë përmbajtje:

*“12. Taksë për qumështin pluhur për tregti ( përfshirë në kreun 0402 të NKM-së).*

*13. Taksë për pijen e homogjenizuar barista ( përfshirë në kreun 0404 të NKM-së).*

*14. Taksë për hirrë qumështi ( përfshirë në kreun 0404 të NKM-së).*

*15. Taksë për krem qumështi ( përfshirë në kreun 0402 të NKM-së).*

*16. Taksë për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, të përcaktuara sipas ligjit “Për aktivitetet e turizmit detar.”.*

Neni 2, parashikon që në nenin 4, “Niveli i taksave kombëtare” shtohen pikat 12 deri 16 me këtë përmbajtje:

*“12. Taksa për qumështin pluhur është në vlerën 100 lekë për kg.*

*13. Taksa për pijen e homogjenizuar barista është në vlerën 16 lekë për liter.*

*14. Taksa për hirrë qumështi është në vlerën 150 lekë për kg.*

*15. Taksa për krem qumështi është në vlerën 150 lekë për liter.*

*16. Taksa për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, të përcaktuara sipas ligjit “Për aktivitetet e turizmit detar” është në vlerën 65 lekë/litër.”.*

Neni 3, parashikon që në nenin 5, “Agjentët e taksave” shtohen shkronjat “h” deri “l”: me këtë përmbajtje:

- “h) për taksën e importimit të qumështit pluhur organet doganore.*
- i) për taksën për pijen e homogjenizuar barista, organet doganore .*
- j) për taksën për hurrë qumështi organet doganore.*
- k) për taksën për krem qumështi organet doganore.*
- l) për taksën për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, organet doganore.”.*

Neni 4, parashikon që në nenin 9 “përjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare”, shtohet pika 8 me këtë përmbajtje”

*“8. Përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hurrë qumështi dhe taksës për krem qumështi, fabrikat e prodhimit me etiketë të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.”.*

Në nenin 5 parashikohet që ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QE NGARKOHEN PER ZBATIMIN E KETIJ PROJEKTAKTI**

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Administrata Doganore për zbatimin e këtij projektligji.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QE KANE KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar projektligjin.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Duke parashikuar një import mesatar prej rreth 1.000 ton qumësht pluhur në vit, referuar të dhënave të vitit 2019 dhe gjashtëmuajorit të parë të vitit 2021 (duke

qenë se 2020 konsiderohet vit i vecantë për shkak të pandemisë), me vendosjen e taksës 100 lek/kg parashikohet një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me rreth + 100 milion lekë në vit.

Referuar një importi mesatar prej rreth 150 mijë kg hirrë qumështi në vit, (në bazë të të dhënave të viteve 2019, 2020 dhe 2021), me vendosjen e taksës 150 lek/kg parashikohet një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me rreth + 22.5 milion lekë në vit.

Duke parashikuar një import mesatar prej rreth 490 mijë litra për pijen e homogjenizuar në vit, (referuar të dhënave të viteve 2019, 2020 dhe 2021), me vendosjen e taksës 16 lek/litër parashikohet një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me rreth + 7.8 milion lekë në vit.

Duke qenë se parashikohet një furnizim i mjeteve lundruese për argëtim me karburant, mesatarisht në vlerën rreth 18 mijë ton në vit ose thënë ndryshe rreth 21 milion litra karburant në vit, atëherë nga vendosja e taksës në vlerën 65 lekë për litër parashikohet një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me rreth +1.350 miliardë lekë në vit.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**